

## Rezyme

Në këtë studim është bërë përpjekje që të ndriçohet funksioni i shenjave nominale tekstore në tekstin e këngës „Mertesa e Halilit” nga „Lahuta e Malcis” dhe në versionin e përkthyer në gjuhën gjermane nga albanologu austriak Maximilian Lambertz.

Shenjat nominale si konstituentë të rëndësishëm tekstndërtues, kanë funksion të posaçëm në aktin e komunikimit, në të cilin koduesi dhe dekoduesi determinohen si negativ, sepse situata nuk u referohet këtyre dy faktorëve kontekstualë. Ne jemi mbështetur në rolin referencial të shenjave nominale në tekstin e analizuar, siç janë përsëritjet tekstuale (textuelle Rekurrenz), konstituentët e tematikës tekstuale (konstituive für die textuelle Thematik) dhe kuazipërsëritjet (Quasi – Rekurrenz) si përbërës të kohezionit të tekstit.

Ndërkaq, në punim janë shqyrtuar dhe përbërësit informativë të tekstit: tema (Thema) dhe rema (Rhema), si konstituentë primar të koherencës tekstore, në mënyrë që të qartësohet funksioni i shenjave nominale dhe roli i tyre në ndërtimin e këtij teksti si njësi integrale.